



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT**

V E N D I M

Nr. 47, datë 24.04.2026

PËR

**MIRATIMIN E NDYSHIMIT TË PROJEKTIT GJATË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“NDËRTIMI I FABRIKËS SË TEKSTILEVE ME 3 DHE 4 KATE MBI TOKË DHE 1 KAT
NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË KAMËZ**

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “KAYO” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të projektit gjatë ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i fabrikës së tekstileve me 3 dhe 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Kamëz, me subjekt zhvillues shoqërinë “KAYO” sh.a., miratuar me Vendimin Nr. 07, datë 25.09.2025 të Këshillit Kombëtar të Territorit, dhe pajisur me Lejen e Ndërtimit Nr. 961 Prot., datë 03.02.2026.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur Vendimit Nr. Nr. 07, datë 25.09.2025 të Këshillit Kombëtar të Territorit, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I MBROJTJES
ERNALNUFI



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 30/06 2026